
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Zyra e Personelit Kancelaria za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.72/19	Datë: 04.04 .2019	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil , Komuna e Istogut shpall :

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Vendi i punës : Zyrtar/e për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve Kapitale

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, kohëzgjatja 6 muaj.

Numri i referencës: 02Nr.72/19

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 400 euro

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Përcjell dokumentacionin dhe pagesat për investimet e bëra në projekte të drejtorisë së shërbimeve publike;
- Përgatitë projekt-propozimet për vitin vijues sipas kërkesës së donatorëve të mbështetur në strategjinë zhvillimore të Komunes;
- Punimi i projekt-propozimeve , më parë të identifikuar nga sektori i shërbimeve publike , komuniteti dhe donatorët;
- Bashkëpunim i rregullt me zyrën e prokurimit dhe drejtoritë tjera ;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe në komisionet të pranimit, me rastin e përfundimit të projekteve kapitale;
- Puna me palë;
- Kryen edhe detyra tjera të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kane shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Dokumentet:

- Diplomë Univerzitare apo diplomë të Kolegjeve të akredituara, drejtimi i arqitekturës;
- 2 vite përvojë pune në profesion;
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit, procedur e shpejtuar.

Data e shpalljes së konkursit: 04.04.2019 deri më 11.04.2019

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



**Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi**